



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 65 prot.

Kamëz, më 19.05.2021

VENDIM

Nr. 54.Datë 19.052021

PËR

MIRATIMIN E NJË SHTESE NË LISTËN E VENDIMIT NR. 23 DATË 19.02.2021 TË SUBJEKTEVE TË CILËT PËRFITOJNË NGA GRANTET PËR RINDËRTIMIN E BANESAVE INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMRTIT TË DATËS 26. NËNTOR 2019, VLERËSUAR SIPAS NIVELIT TË DËMTIMEVE NGA DS1-DS3

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më **19.05.2021** në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19, pasi mori në shqyrtim **Projekt – Vendim Nr.50 Datë 11.05.2021** në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, aktin nr. 09 datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” dhe aktet nënligjore për zbatim të tij, Vendimin nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar, Vendim Nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, Vendimit Nr.5, datë 06.01.2020 i ndryshuar “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, Vendim Nr.8, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje”, Vendimit Nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përsheptuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, Vendim Nr.22, datë 13.02.2020, të Këshillit Bashkiak Kamëz “Për miratimin e manualit të procedurave për përfitimin nga programet e rindërtimit”,
Këshilli Bashkiak Kamëz:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

V E N D O S I :

1. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin nr.168 Datë 23.12.2020 të subjekteve përfitues, të cilët plotësojnë kriteret ligjore për të përfituar nga grantet e rindërtimit për masën e dëmtimeve sipas DS-ve:

- DS1 - Nivel dëmtimi lehtë;
- DS2 - Nivel dëmtimi mesatar;
- DS3 - Nivel dëmtimi serioze;

2. Miratimin për një shtesë në listën e vendimit nr. 168. Datë 23.12.2020 në listën e subjekteve përfitues, të cilët plotësojnë kriteret ligjore për të përfituar nga grantet e rindërtimit për masën e dëmtimeve sipas DS-ve

DS1 - Nivel dëmtimi lehtë;
DS2 - Nivel dëmtimi mesatar;
DS3 - Nivel dëmtimi serioze;

3. Miratimin për vlerën në lekë hartuar nga Komisioni Teknik sipas urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Nr. 155 datë 24.02.2020 për përcaktimin e vlerës të masës së grantit të rindërtimit sipas nivelit të dëmtimeve nga tërmeti.

Relacioni u dorëzua pranë Komisionit të Posaçëm me
Nr.3784 prot datë 26.05.2020 dhe si më poshtë vijon:

DS-1 përfiton grantin me vlerë 90,154 (nëntëdhjetë mijë e njeqin e pesëdhjete e kater lekë)
DS-2 përfiton grantin me vlerë 230,060 (dyqind e tridhjetëmijë e gjashtedhjete lekë)
DS-3 përfiton grantin me vlerë 450,062 (katërqind e pesëdhjetëmijë e gjashtedhjete e dy lekë)

4. Lista e subjekteve që shfuqizohennë pikën 1 të këtijvendimi, paraqitet në aneksin bashkëlidhur dhe është pjesë e ketijë vendimi.

5. Lista e subjekteve shtesë përfitues e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, paraqitet në aneksin bashkëlidhur dhe është pjesë e këtij vendimi.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

6. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

**Nën/ Kryetar Këshilli
Ali Dauti**

